Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike nr.8 ,date 24.01.2022

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë keta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. O.Ekonomik “GJEO-WIND”SH.P.K me nr. NIPT-it M18725301R ,
me vlere oferte 1,316,000 (Njemilion e treqinde e gjashtembedhjetemije) leke pa tvsh.

Jane skualifikuar ofertuesit e meposhtem: Nuk pati operatorë të skualifikuar

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë O Ekonomik “GJEO-WIND”SH.P.K. me nr. NIPT-it M18725301R me adrese Shkoder,Puke,Apartament Puke,Godina 1,Hyrja 1,Zona kadastrale 3069,vol3,faqe 27 me numer pasurie 1/25+1-2. se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 1,316,000 (Njemilion e treqinde e gjashtembedhjetemije) leke pa tvsh. është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [Bashkise Puke, Sheshi Gjergj Kastriot Skenderbeu Puke], kopjen e formularit të sigurimit të kontratës, , brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi. siç parashikohet në dokumentat e Ankandit.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe procedura do të anulohet, siç parashikohet në nenin 39 të Ligjit nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për Ankandin Publik” (i ndryshuar).

Njoftimi i klasifikimit është bërë me date 15.02.2022

Ankesa: Ska patur

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E REZERVAVE MATERIALE TË
SHTETIT
NJOFTIM FITUESI

Për: [Florinda SHIMA - Person Fizik, numri i NIPT-it: L81406022B]

Procedura e ankandit: [3B/2022 datë 01.03.2022]

Përshkrim i shkurtër i procedurës së ankandit dhe objektit të tij: [Mjete motorike të kategorizuara për qarkullim të ndara në 90 lote]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [07.02.2022] [15].

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Florinda SHIMA - Person Fizik, numri i NIPT-it: L81406022B.

Vlera: për lotin Nr.2, vlerë 320000 (Treqind e njëzetmijë) lekë pa TVSH dhe 384000 (Treqind e tetëdhjetë e katërmijë) lekë me TVSH.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [Florinda SHIMA - Person Fizik] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [320000 (Treqind e njëzetmijë) lekë pa TVSH dhe 384000 (Treqind e tetëdhjetë e katërmijë) lekë me TVSH] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, me adresë K.3, G. 29, E QKMBM dhe MFA, Garnizoni Skënderbej, Rr. e Dibrës, Tiranë, Albania] kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 01.03.2022, në prezencë të ofertuesit.

AGROKREDIT
NJOFTIM FITUES ANKANDI

- Klodian Polisi me nr. personal identifikimi J10516028W.
- Katerina Dragoj me nr. personal identifikimi J35706031K.
- Aida Moci me nr. personal identifikimi I25302129Q.

* * *

Procedura e ankandit: Procedure e Hapur me objekt: “Shitje prona te Agrokredit sh.a” i ndare ne 5 lote:

Loti 1: Truall me siperfaqe totale 300 m2 nga kjo truall 300 m2 nga kjo ndertese 105 m2 (Zona Kadastrale 3066, Numri i Pasurise 99 /5 /1, Volumi 3, Faqe.87) Adresa Psar, Kolonje. Çertifikatë

për Vërtetim Pronësie Nr.1676314, lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Z.V.R.P.P. KOLONJE me datë 24.12.2014. Kodi i Prones MP47.

Loti 2: ARË me Sipërfaqe Totale 750 m2. (Zona kadastrale 2631, Numri i Pasurisë 170/96, Volumi 11, Faqe 149. Adresa e Pasurisë Mborje Korçe. Çertifikatë Regjistrimi Pronësie, KODI UNIK 2631011149 lëshuar nga Agjensia Shtetërore e Kadastres, Drejtoria Vendore Korçe Mborje me date 23.11.2021. Kodi i Prones MP444

Loti 3: Are + Truall me sipërfaqe totale 510 m2 nga kjo Truall 400 m2 nga kjo Ndertese 175 m2. (Zona kadastrale 3502, Numri i Pasurisë 176/6 Vol. 12 Faqe 156). Adresa e pasurisë Zemblak, Korçe. Çertifikatë Regjistrimi Pronësie, KODI UNIK 3903012156 lëshuar nga Agjensia Shtetërore e Kadastres, Drejtoria Vendore Korçe me date 13.12.2021. Kodi i Prones MP 448.

Loti 4: Arë sipërfaqe Totale 2700 m2. Adresa e Pasurisë Vehcan, Librazhd. (Zona Kadastrale 3725, Numri i Pasurisë 140/1, Volumi.3, Faqe.56). Çertifikatë për Vërtetim Pronësie Nr.740537, Lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Librazhd me datë 30.09.2014. Kodi i Prones MP 105.

Loti 5: Truall sipërfaqe Totale 150m2, nga kjo Truall 150 m2, nga kjo Ndertese 68 m2. Adresa e Pasurisë. Vehcan, Librazhd. (Zona Kadastrale 3725, Numeri i Pasurisë 295/9, Volumi 5, Faqe 157). Çertifikatë për Vërtetim Pronësie Nr.740538, Lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Librazhd me date 30.09.2014. Kodi i prones MP 106.

Afati për ekzekutimin e kontratës është 30 ditë nga nënshkrimi i kontratës së shitjes.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Nuk ka pasur

Njoftojme se, kanë qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:

Loti 1: Truall me sipërfaqe totale 300 m2 nga kjo truall 300 m2 nga kjo ndertese 105 m2 (Zona Kadastrale 3066, Numri i Pasurisë 99 /5 /1, Volumi 3, Faqe.87) Adresa Psar, Kolonje. Çertifikatë për Vërtetim Pronësie Nr.1676314, lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Z.V.R.P.P. KOLONJE me datë 24.12.2014. Kodi i Prones MP47.

Zj. Aida Moci me nr. personal identifikimi I25302129Q.

Vlera e ofruar per Lotin 1: 550,000 (peseqind e pesedhete mije) leke pa tvsh.

Loti 3: Are + Truall me sipërfaqe totale 510 m2 nga kjo Truall 400 m2 nga kjo Ndertese 175 m2. (Zona kadastrale 3502, Numri i Pasurisë 176/6 Vol. 12 Faqe 156). Adresa e pasurisë Zemblak, Korçe. Çertifikatë Regjistrimi Pronësie, KODI UNIK 3903012156 lëshuar nga Agjensia Shtetërore e Kadastres, Drejtoria Vendore Korçe me date 13.12.2021. Kodi i Prones MP 448.

Zj. Katerina Dragoj me nr. personal identifikimi J35706031K.

Vlera e ofruar per Lotin 3: 401,000 (katerqind e nje mije) leke pa tvsh.

Loti 5: Truall sipërfaqe Totale 150m2, nga kjo Truall 150 m2, nga kjo Ndertese 68 m2. Adresa e Pasurisë. Vehcan, Librazhd. (Zona Kadastrale 3725, Numeri i Pasurisë 295/9, Volumi 5, Faqe 157). Çertifikatë për Vërtetim Pronësie Nr.740538, Lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Librazhd me date 30.09.2014. Kodi i prones MP 106.

Z. Klodian Polisi me nr. personal identifikimi J10516028W.

Vlera e ofruar per Lotin 5: 81,000 (tetedhete e nje mije) leke pa tvsh.

Jane skualifikuar ofertuesit e meposhtem: Nuk ka ofertues te skualifikuar.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë

- Zj. Aida Moci, me nr. personal identifikimi I25302129Q, se oferta e paraqitur per Lotin 1: Truall me siperfaqe totale 300 m2 nga kjo truall 300 m2 nga kjo ndertese 105 m2 (Zona Kadastrale 3066, Numri i Pasurise 99 /5 /1, Volumi 3, Faqe.87) Adresa Psar, Kolonje. Çertifikatë për Vërtetim Pronësie Nr.1676314, lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Z.V.R.P.P. KOLONJE me datë 24.12.2014. Kodi i Prones MP47, me një vlerë të përgjithshme prej 550,000 (peseqind e pesedhjetë mijë) leke pa tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.
- Zj. Katerina Dragoj me nr. personal identifikimi J35706031K se oferta e paraqitur per Lotin 3: Are + Truall me siperfaqe totale 510 m2 nga kjo Truall 400 m2 nga kjo Ndertese 175 m2. (Zona kadastrale 3502, Numri i Pasurisë 176/6 Vol. 12 Faqe 156). Adresa e pasurise Zemblak, Korçe. Çertifikatë Regjistrimi Pronësie, KODI UNIK 3903012156 lëshuar nga Agjencia Shteterore e Kadastres, Drejtoria Vendore Korce me date 13.12.2021. Kodi i Prones MP 448, me një vlerë të përgjithshme prej 401,000 (katerqind e nje mijë) leke pa tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.
- Z. Klodian Polisi me nr. personal identifikimi J10516028W se oferta e paraqitur per Lotin 5: Truall siperfaqe Totale 150m2, nga kjo Truall 150 m2, nga kjo Ndertese 68 m2. Adresa e Pasurise. Vehcan, Librazhd. (Zona Kadastrale 3725, Numeri i Pasurise 295/9, Volumi 5, Faqe 157). Çertifikatë për Vërtetim Pronësie Nr.740538, Lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Librazhd me date 30.09.2014. Kodi i prones MP 106, me një vlerë të përgjithshme prej 81,000 (tetedhjetë e nje mijë) leke pa tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni te lutur të paraqisni pranë AgroKredit sh.a me adrese Rr.Elbasanit, Nr.178/1, NJA Nr.2, Bashkia Tiranë, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjete) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar,., siç parashikohet në nenin siç parashikohet në 39 të ligjit Nr.9874, datë 14.2.2008 "PËR ANKANDIN PUBLIK".

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 22.02.2022

Ankesa: Nuk ka pasur

DREJTORIA RAJONALE E REZERVAVE MATERIALE TË SHTETIT
TIRANË
NJOFTIM FITUESI

Autoriteti Shitës. Drejtoria Rajonale e Rezervave Materiale të Shtetit Tiranë njofton se në ankandin me Nr.Ref. 3A/2022 të zhvilluar me datën 22.02.2022 ora 12.00 me objekt shitjen sipas publikimit të njoftimit në buletin Nr.12, datë 31.01.2022 faqe 226, mori pjesë një ofertues si më poshtë :

1. Balkan Consulting Shpk, me NIPT: L52230034A rezultoi i suksesshëm për këtë procedurë ankandi me vlerë totale 1 058 903 (Njëmilion e pesëdhjetë e tetëmijë e nëntëqind e tre) lekë me TVSH, 882 419 (Tetëqind e tetëdhjetë e dymijë e katërqind e nëntëmbëdhjetë)lekë pa TVSH, për “Mallra të konfiskuara gjendje si pasojë e kundravajtjeve administrative”, dhe ftohet të lidhë kontratën e shitjes publike brenda 10 ditëve nga publikimi i këtij njoftimi .

Në këtë procedurë ankandi nuk rezultoi asnjë ofertues i skualifikuar.

Kjo procedurë ankandi u realizua plotësisht.

KONTRATA TËLIDHURA ANKANDI

ANULLIME ANKANDI

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E REZERVAVE MATERIALE TË

SHTETIT

ANULLIM ANKANDI

Procedura e ankandit: [4A/2022 datë 22.02.2022].

Përshkrim i shkurtër i procedurës së ankandit dhe objektit të tij: [Skrap hekuri dhe skrap alumini i përftuar nga materiale të ndryshme të nxjerra jashtë përdorimit].

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [31.01.2022] [12], faqe 216-217.

Njoftojmë se kjo procedurë ankandi konsiderohet e dështuar për arsye të mos paraqitjes të asnjë oferte/ofertuesi.

BASHKIA CËRRIK

ANULLIM ANKANDI

1. Autoriteti shitës.: “Bashkia Cerrik” me adresë: Lagjja nr.2 Rruga Gjinnazistet

2. Data e zhvillimit të ankandit :
“Shitje karton”, më datë 24.02.2022, ora 10:00

3. Lloji i Procedurës së ankandit: “Procedurë e hapur” .

4. Objekti i shitjes: Shitje kartoni , për sasinë totale 9 ton (nente) në vlerën 99000 (nentedhjetë e nente mijë) lekë pa tvsh.

5. Përshkrim i shkurtër i objektit të shitjes :” Shitje karton”

6. Vlera fillestare : Shitje karton cili do të zhvillohet në datën 24.02.2022 , ora 10:00 , me objekt Shitje karton , për sasinë totale 9ton (nente) dhe me vlerë fillestare 99000 (nentedhjetë e nente mijë) lekë pa tvsh.

7. Vendi i zhvillimit të ankandit (Adresa): Salla e keshillit Bashkiak. Kati i trete, Bashkia Cerrik

8. Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: datë 24.02.2022 ora 10: 00
Autoriteti shitës njofton se deri në afatin e përcaktuar datë 24.02.2022 të publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 15 date 07.02.2022 nuk u paraqit asnjë ofertë. Për vazhdimin e procedurës duhet të paktën 1 (një) ofertë e vlefshme. Në mbështetje të Ligjit nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për Ankandin Publik”, i ndryshuar, VKM-në nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për Miratimin e Rregullave të

Ankandit Publik” e ndryshuar, autoriteti shitës Bashkia e Durrës për shkak mungesës së konkurrencës vendosi anulimin e procedurës së ankandit për të rishpallur një procedurë të re.

DEGA E DOGANËS DURRËS

ANULLIM ANKANDI

5. Autoriteti shitës: DEGA E DOGANËS DURRËS
(adresa, nr. tel) PORT DURRËS, TEL. 0682025431
6. Data e zhvillimit të ankandit: 21.02.2022 ora 10:00
7. Lloji i Procedurës standarde të ankandit: HAPUR
8. Objekti i Shitjes: “Artikulli derivat Nmethylaninine 96 %” me KN *29214200* dhe peshë 66 ton”
9. Përshkrim i shkurtër i objektit të shitjes: “Artikulli derivat Nmethylaninine 96 %” me KN *29214200* dhe peshë 66 ton”
10. Vlera fillestare: 15 369 932 (pesëmbëdhjetë milion e treqindëgjashtëdhjetëenëntë mijë e nëntëqindëtridhjetë e dy) lekë
11. Vendi i zhvillimit të ankandit: (Adresa:) Dega e Doganës Durrës, Port Durrës
12. Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: 21.02.2021 ora 10:00
13. Arsytet e anulimit: Mungesa e konkurrencës si rezultat i mosparaqitjes të asnjë oferte deri në afatin e fundit të pranimit të ofertave, mbështetur në Ligjin nr. 9874 datë 14.02.2008 “Për Ankandin Publik” (ndryshuar), në kreu VI “Kushte të përgjithshme për zbatim” pika 6, germa “a”, “Mungesa e konkurrencës” të VKM Nr.1719 datë 17.12.2008 “Për Miratimin e Rregullave të Ankandit Publik” (I ndryshuar),

AGROKREDIT.SHA.

ANULLIM ANKANDI

PER: LOTIN NR.2 DHE LOTIN NR.4

1. Autoriteti shitës: Agrokredit.sha.
2. Lloji i Procedurës standarde të ankandit: Procedure e Hapur
3. Objekti i Shitjes: “Shitje prona të Agrokredit sh.a” i ndarë në 5 lote:

Loti 1: Truall me sipërfaqe totale 300 m2 nga kjo truall 300 m2 nga kjo ndertese 105 m2 (Zona Kadastrale 3066, Numri i Pasurise 99 /5 /1, Volumi 3, Faqe.87) Adresa Psar, Kolonje. Çertifikatë për Vërtetim Pronësie Nr.1676314, lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Z.V.R.P.P. KOLONJE me datë 24.12.2014. Kodi i Prones MP47.

Loti 2: ARË me Sipërfaqe Totale 750 m2. (Zona kadastrale 2631, Numri i Pasurisë 170/96, Volumi 11, Faqe 149. Adresa e Pasurisë Mborje Korçe. Çertifikatë Regjistrimi Pronësie, KODI UNIK 2631011149 lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastres, Drejtoria Vendore Korçe Mborje me date 23.11.2021. Kodi i Prones MP444

Loti 3: Are + Truall me sipërfaqe totale 510 m2 nga kjo Truall 400 m2 nga kjo Ndertese 175 m2. (Zona kadastrale 3502, Numri i Pasurisë 176/6 Vol. 12 Faqe 156). Adresa e pasurise Zemblak, Korçe. Çertifikatë Regjistrimi Pronësie, KODI UNIK 3903012156 lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastres, Drejtoria Vendore Korçe me date 13.12.2021. Kodi i Prones MP 448.

Loti 4: Arë sipërfaqe Totale 2700 m2. Adresa e Pasurise Vehcan, Librazhd. (Zona Kadastrale 3725, Numri i Pasurise 140/1, Volumi.3, Faqe.56). Çertifikatë për Vërtetim Pronësie Nr.740537, Lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Librazhd me datë 30.09.2014. Kodi i Prones MP 105.

Loti 5: Truall sipërfaqe Totale 150m2, nga kjo Truall 150 m2, nga kjo Ndertese 68 m2. Adresa e Pasurise. Vehcan, Librazhd. (Zona Kadastrale 3725, Numeri i Pasurise 295/9, Volumi 5, Faqe 157). Çertifikatë për Vërtetim Pronësie Nr.740538, Lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Librazhd me date 30.09.2014. Kodi i prones MP 106.

4. Data e zhvillimit të ankandit: 22.02.2022, ora 10:00

Autoriteti Shites – Agrokredit sh.a, njofton se deri në afatin e përcaktuar datë 22.02.2022, ora 10:00 për procedurën e mesipërme të shitjes të publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nuk u paraqit asnjë ofertë për Lotet e mëposhtem:

Loti 2: ARË me Sipërfaqe Totale 750 m2. (Zona kadastrale 2631, Numri i Pasurisë 170/96, Volumi 11, Faqe 149. Adresa e Pasurisë Mborje Korçe. Çertifikatë Regjistrimi Pronësie, KODI UNIK 2631011149 lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastres, Drejtoria Vendore Korçe Mborje me date 23.11.2021. Kodi i Prones MP444

Loti 4: Arë sipërfaqe Totale 2700 m2. Adresa e Pasurise Vehcan, Librazhd. (Zona Kadastrale 3725, Numri i Pasurise 140/1, Volumi.3, Faqe.56). Çertifikatë për Vërtetim Pronësie Nr.740537, Lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Librazhd me datë 30.09.2014. Kodi i Prones MP 105.

Duke qene se për vazhdimin e procedurës duhet të paktën 1 (një) ofertë e vlefshme, mbeshtetur në Ligjin nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për Ankandin Publik”, i ndryshuar, dhe VKM-në Nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për Miratimin e Rregullave të Ankandit Publik”, i ndryshuar, autoriteti shitës, për shkak mungesës së konkurrencës, vendosi anulimin e procedurës së ankandit për të rishpallur një procedurë të re për lotet që nuk u paraqit asnjë oferte.

DREJTORIA RAJONALE E REZERVAVE MATERIALE TË SHTETIT
TIRANË
ANULLIM ANKANDI

Autoriteti Shites – Drejtoria Rajonale e Rezervave Materiale të Shtetit Tiranë, njofton se në ankandin me nr.ref.2A-2022, zhvilluar datë 22.02.2022, ora 11:00 me objekt sipas publikimit të bërë në Buletinin e Njoftimeve Publike nr.12 , të datës 31.01.2022 , faqe 225-226 të APP-së , nuk u paraqit asnjë kandidat/ofertues.

Kështu që në mbështetje e për zbatim të Ligjit nr.9874, datë 14.02.2008 “Për Ankandin Publik ” dhe pikës 6/a të Kreut VI, “Kushte të përgjithshme për zbatim” të VKM-së Nr.1719 datë 17.02.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, që të vazhdojë procesi i përzgjedhjes së fituesit në vijim të procedurës së hapur, duhet të pranohet të paktën 1 (një) ofertë e vlefshme. Në këtë rast nuk kemi asnjë ofertues për vijimësinë e procedurave, shkak i cili çon në dështimin e këtij ankandi.

TË TJERA ANKANDE

KREU I DYTË

Buletini

i

Departamentit

të Administratës

Publike

KREU I KATËRT

Buletini i

ofertave të qirave

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
NJOFTIM PËR MARRJE ME QIRA

1. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave njofton të interesuarit/konkurrentët se kërkon të marrë me qira godinë/objekt ndërtimor për ushtrimin e veprimtarisë së një pjese të stafit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, duke u bazuar në kriteret e mëposhtme:
 - Të jetë objekt ndërtimor me sipërfaqe rreth 1500 m², i pershtatur për zyra të ndara e domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë së një pjese të stafit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave;
 - Vendodhja e godinës të jetë brenda një rrezeje 5 km nga qendra e qytetit. Objekti të ketë ambiente të përshtatshme për zyra, parkim automjete dhe të jetë lehtësisht i aksesueshëm në akset kryesore rrugore.
 - Objekti të ketë hapësirë parkimi për 50 mjete autovetura;
 - Të ketë sipërfaqe të mjaftueshme për mbarëvajtjen e punës.
 - Duke u nisur nga rëndësia e Institucionit të jetë e përshtatshme për ruajtjen e sigurisë së ambjenteve;
 - Të jetë një objekt qëllimi i të cilit të jetë kryesisht për ambjente pune, jo godinë që ka destinacion bar apo hotel;
 - Në objekt të jetë i siguruar furnizimi pa ndërpreje për 24 orë në 7 ditë i energjisë elektrike dhe uji, të ketë sistem ngrohje dhe ftohje të instaluar, rrjet kompjuterik, dhomë të dedikuara serverash, sistem sigurimi me kamera;
 - Mirëmbajtja e ambjenteve të përbashkëta si dhe riparime të ndryshme të ambjenteve të brendshme;
 - Objekti të jetë i hipotekuar dhe të ketë një Gent Plan;
 - Vlera fillestare për konkurrim është 352.800 lekë (treqind e pesëdhjetë e dy mijë e tetëqind) lekë në muaj ose 4.233.600 lekë (katërmijë e dyqind e tridhjetë e tre mijë e gjashtëqind) në vites sipas VKM-së 469 datë 03.06.2015 referuar pasqyres llogaritëse me poshtë:

Logaritja e vlerës minimale bazuar në VKM Nr. 469, datë 03.06.2015 “Për përcaktimin e vlerës minimale të cmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”.

Bazuar në pikën 3, germa c) e cila citon: “Për 1 m² sipërfaqe për zyrë dhe magazinë, vlera minimale e qirasë mujore është e barabartë me vlerën minimale të qirase mujore për 1 m² sipërfaqe të apartamenteve të banimit sipas zonave të Tiranës”.

Bazuar në Vkm Nr.168, datë 27.03.2019, Për disa ndryshime në Vendimin Nr.132, datë 07.03.2018 të Këshillit të Ministrave, “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “Ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, ANEKSI 1, Çmimet mesatare referuese për metër katror sipërfaqe ndërtimi për vlerësimin e vlerës së taksueshme për banesat, pika a), nëndarja a.2), Zona 11/3 me vlerë 70.000 lekë.

$70.000 \text{ lekë} \times 0.3\% \text{ (koeficienti i cmimit të shitjes)} = 210 \text{ lekë/m}^2$

$210 \text{ lekë/m}^2 \times 1500 \text{ m}^2 = 315.000 \text{ Lekë në muaj}$

$315.000 \text{ lekë në muaj} \times 12 \text{ muaj} = 3.780.000 \text{ lekë në vit}$

Bazuar në pikën 3, germa ç) e cila citon: “Për 1 m² sipërfaqe për parkim të hapur, vlera minimale e qirasë mujore është 30% e vlerës minimale të qerases mujore për 1 m² sipërfaqe të apartamenteve të banimit, sipas zonave të Tiranës.(Parkimi mund të jetë edhe i mbyllur).

Bazuar në Vkm Nr.168, datë 27.03.2019 Për disa ndryshime në Vendimin Nr.132, datë 07.03.2018 të Këshillit të Ministrave, “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “Ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për

përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, ANEKSI 1, Çmimet mesatare referuese për metër katror sipërfaqe ndërtimi për vlerësimin e vlerës së taksueshme për banesat pika a), nëndarja a.2), Zona 11/3 me vlerë 70.000 lekë.

$$0.3 \text{ (koeficienti i cmimit të shitjes)} \times 70.000 \text{ Lek/m}^2 = 210 \text{ Lek/m}^2$$

$$0.3 \times 210 \text{ Lek/m}^2 = 63 \text{ Lek/m}^2$$

$$63 \text{ Lek/m}^2 \times 600 \text{ m}^2 = 37.800 \text{ Lekë/muaj}$$

$$37.800 \text{ Lekë në muaj} \times 12 \text{ muaj} = 453.600 \text{ Lekë/vit}$$

$$\text{Totali mujor : } 315.000 \text{ Lek në muaj} + 37.800 \text{ Lek në muaj} = 352.800 \text{ Lekë/muaj}$$

$$\text{Totali vjetor : } 3.780.000 + 453.600 = 4.233.600 \text{ Lekë/vit.}$$

Fondi limit për konkurim është:

$$\text{Totali mujor i korigjuar: } 508'032 + (508'032 \times 20\%) = 609'638 \text{ (gjashtëqind e nëntë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e tetë) lekë/muaj}$$

$$\text{Totali vjetor i korigjuar: } 6'096'384 \times 12 \text{ muaj} = 7'315'656 \text{ (shtatë milion e treqind e pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë/vit}$$

Kriteret kualifikuese të operatorëve ekonomike pjesëmarrës

Ofertat që do të paraqesin konkurrentët për konkurim përbëhet nga dokumentacioni i mëposhtëm:

- a. kërkesa e subjektit për pjesëmarrje në konkurim;
- b. deklaratat e hollësishme për vënien në funksionim të objektit, për veprimtari doganore;
- c. oferta për vlerën e detyrimit mujor të qirasë;
- d. formulari i sigurimit të ofertës në vlerën 2% të VFQ. Sigurimi i ofertës është i vlefshëm për 100 ditë nga afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave.
- e. vërtetimi që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka subjekti konkurrues. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e konkurruesit, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë.
- f. NIPT/NUIS-i, certifikata e regjistrimit dhe certifikata historike e regjistrimit të subjektit në QKR;
- g. vërtetimi nga Dega e Tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore;
- h. vërtetime nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin.

Mosparaqitja e njërit prej dokumentave të mësipërme, përbën kusht skualifikues.

Afati i fundit kohor për dorëzimin e ofertave konkurrese është data 09/03/2022.

BASHKIA MALËSI E MADHE

NJOFTIM PËR ANULLIM PROCEDURE MARRJE ME QIRA

Bashkia Malësi e Madhe ka publikuar njoftimin për marrje me qira një objekt (Ndërtesë + tokë) për stacionimin e automjeteve të Bashkisë, për depozitimin e druve dhe për zyrat Ndërmarrjes së Shfrytëzimit Pyjor me Buletinin nr. 23 datë 21.02.2022

Sipas të dhënave të më poshtme

1. Sipërfaqja e nevojshme për parkimin e automjeteve të bashkise eshte 1000 m².
2. Sipërfaqja për venddepozitimin dhe përpunimin e druve është 1500 m².
3. Sipërfaqe ndërtese të nevojshme për zyra , 3 ambjente me sipërfaqe rreth 60 m².
4. Sipërfaqe ndërtese të nevojshme për magazinimin, 3 ambjente me sipërfaqe rreth 300 m².
Sipërfaqe trualli totale 2500 m².
Sipërfaqe ndërtese totale 360 m².
5. Të ketë furnizim me energji elektrike me 3 fazor, me kontratë të rregullt, ose të plotësojë kushtet për kontratë të re.
6. Distanca e ambjentit nga qendra e bashkisë mos të jetë më larg se 2 km vije ajrore.
7. Përbëjnë avantazh furnizimi me uje, si dhe lidhja me afërt me infrastrukturen kryesore rrugore.
8. Siperfaqja truallit dhe nderteses që do merren me qera duhet te jenë në funksion të njera-tjetrës.
9. Objekti duhet të jetë i paisur me certifikatë pronësie.

Duke qënë se në afatin e fundit për pritjen e ofertave nuk u paraqit asnjë kërksë për pjesmarrje, njoftojmë anullimin e procedurës për marrjen me qira.

BASHKIA GRAMSH

NJOFTIM KONTRATE NËNSHKRUAR PËR DHËNIE ME QIRA

1. Autoriteti Kontraktor: Bashkia Gramsh, me adrese, Bulevardi Kryesor “10 Korriku”, sheshi “Kamber Dërmyshi”, Lagjia “Holta”, tel/fax. +35551322272, www.bashkiagramsh.gov.al
2. Lloji i procedurës se Konkurimit : “E hapur”
3. Objekti i Konkurimit: “Për dhënien me qira të fondit pyjor/kullor të ndodhur në në Zonën Kadastrale 1830, nëngrastrat pyjore 15/a dhe 15/b të ekonomisë pyjore “Dushku i Bulçarit”.
4. Vlera fillestare e Konkurimit: :845 000 (tetëqind e dyzetë e pesë mijë) lekë/vit
5. Vlera totale e kontratës:846 000(tetëqind e dyzetë e gjashtëmijë) lekë/vit
6. Data e lidhjes së kontratës :Datë 28.02.2022.

7. Kontraktori, Adresa, Nipti: Operatori Ekonomik "Lior 2021" sh.p.k me adresë :Lagjia "Havaleas", rruga Bulevardi "Rinia 17", Zona Kadastrale 1043 , Godinë 2-katëshe , kati i pare , Kozarë, Berat dhe NIPT nr. M12414002A

BASHKIA MALËSI E MADHE
NJOFTIM PER MARRJE ME QIRA

Bashkia Malësi e Madhe kërkon të marrë me qira një objekt (Ndërtesë + tokë) me qira për stacionimin e automjeteve të Bashkisë, për depozitimin e druve dhe për zyrat Ndërmarrjes së Shfrytëzimit Pyjor.

Objekti i kërkuar duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

1. Sipërfaqja e nevojshme për parkimin e automjeteve të bashkisë është 1000 m².
2. Sipërfaqja për venddepozitimin dhe përpunimin e druve është 1500 m².
3. Sipërfaqe ndërtese të nevojshme për zyra , 3 ambjente me sipërfaqe rreth 60 m².
4. Sipërfaqe ndërtese të nevojshme për magazinimin, 3 ambjente me sipërfaqe rreth 300 m².
Sipërfaqe trualli totale 2500 m².
Sipërfaqe ndërtese totale 360 m².
5. Të ketë furnizim me energji elektrike me 3 fazor, me kontratë të rregullt, ose të plotësojë kushtet për kontratë të re.
6. Distanca e ambjentit nga qendra e bashkisë mos të jetë më larg se 2 km vije ajrore.
7. Përbëjnë avantazh furnizimi me uje, si dhe lidhja me afërt me infrastrukturen kryesore rrugore.
8. Sipërfaqja truallit dhe ndertesës që do merren me qira duhet të jenë në funksion të njera-tjetrës.
9. Objekti duhet të jetë i paisur me certifikate pronësie.

Dokumentacioni i ofertuesve që paraqiten për konkurim duhet të përbëhet nga:

- a. Kërkesa e subjektit për pjesëmarrje në konkurim.
- b. Deklarate e hollshme për funksionimin e objektit sipas destinacionit të kërkuar.
- c. Oferta për vlerën dhe detyrimin vjetor të qirasë (e ndarë edhe sipas muajve).
- d. Vërtetim që vërteton shlyerjen e të gjithave detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike.
- e. Mos shlyerja e energjisë elektrike përben shkak për skualifikimin e konkurrensit, pevec rastit ku rrezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike janë në process ankimimi në gjykatë .
- g. Vërtetim nga organet përkatëse që nuk është në ndjekje penale .
- h. Dokumentat e kërkuar mësipër të jenë origjinale ose fotokopje e noterizuar, jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertave.
- i. Në ofertë duhet të deklarohet cmimi për meter katror (ku të përfshihet tatimi në burim).
- j. Dokumenti identifikimi i pronarit të objektit (pasaportë dhe /ose kartë identiteti ID).
- k. Vlera fillestare përkonkurim: 1 274 900 (njemilionedyqindeshatëdhjetekatërmijeenenteqind) lek/vit, sipas VKM-së 469 datë 03.06.2015."Për përcaktimin e vlerës minimale të cmimit të referencave të qerave të ndërtësive për qëllime tatimore".

Ky dokumentacion të paraqitet në një zarf të mbyllur ,nënshkruar nga konkuresi , me mbishkrimin “ Ofertë për dhëniën me qira “ dhe i dorëzohet Komisionit deri në orën e hapjes se konkurrimit. Mosparaqitja e njërit pre dokumtenave të mësipërme ,përben kusht për skualifikim. Vendi i zhvillimit të konkurrimit :Bashkia Malësi e Madhe, Koplík Qendër, Malësi e Madhe . Ofertat dorëzohen nga të intersuarit/konurrentet fizikisht , me postë ose dorazi , në vendin e përcaktuar për zhvillimin e konkurrimit.

Afati i fundit kohor për dorëzimin e ofertave konkurruese është : 15/03/2022.

PROCEDURA KONKURRUESE PËR
LEJE MINERARE

NJOFTIME TË TJERA

QENDRA SHËNDETËSORE FUSHË KRUJË

Njoftim për vend të lirë pune

Mbeshtetur ne urdherin e Ministrit te Shendetesise nr.511 date 13.12.2011' Per kritetret e Punesimit ne Sherbimin Shendetesor Publik,Drejtoria e Qendres Shendetesore Fushe-Kruje shpall nje vend te lire pune :

RECEPTIONIST/E

Kriteret kryesore te punesimit:

- 1.Te kene mbaruar aresimin e larte (perparasi ne Fakultetin e Infermierise).
- 2.Perparasi te jete banore e Bashkise Fushe-Kruje
- 3.Eksperienca ne pune eshte avantazh
- 4.Te jene te komunikueshem me njerezit dhe te afte te punojne ne grup

Kandidatet duhet te paraqesin dokumentat e meposhteme:

- Kerkese me shkrim per aplikim
- Curriculum vitae.
- Dokument identifikimi (karte identiteti ose pasaporte)
- Diplome se bashku me listen e notave te fotokopjuar dhe te noterizuar
- Deshmi e kurseve te trajnimit ose kualifikime ne qofte se kane.
- Reference pune ne qofte se kane.
- Raport Mjeko Ligjor dhe Libreze Shendetesore
- Deshmi te zoterimit te gjuhes se huaj dhe te kompjuterit
- Vertetim banimi.

Te interesuarit te paraqesin dokumentat prane Qendres Shendetesore Fushe-Kruje te mbyllura ne zarf ne 3(tre) kopje 5(pese) dite pas shpalljes se ketij njoftimi .

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

U R D H Ë R

NR._93, DATË_25.02.2022

PËR

NJOFTIMIN E FILLIMIT TË PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT NË UNIVERSITETIN BUJQËSOR TË TIRANËS, MËNYRËN E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE DHE AFATIN E DORËZIMIT TË DOKUMENTACIONIT

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 48 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën Shqipërisë” dhe të pikës 7, të vendimit nr. 782, datë 26.12.2018 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë”,

U R D H Ë R O J:

1. Njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, si përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në Universitetin e Sporteve të Tiranës, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Përzgjedhja e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Administrimit të kryhet në përputhje me kriteret, procedurën dhe dokumentacionin që duhet dorëzuar, sipas përcaktimeve të vendimit nr.782, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave dhe shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri.
3. Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët për anëtarë të Bordit të Administrimit, do të jetë deri në datë _11.03.2022.
4. Publikimi i kriterëve dhe procedurat që do të ndiqen për konkurrimin, për pozicionin anëtar të Bordit të Administrimit si përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në Universitetin Bujqësor të Tiranës, të bëhet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsimin, Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Qendrës së Botimeve Zyrtare dhe në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik.
5. Lista e kandidatëve të përzgjedhur publikohet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsimin, www.arsimi.gov.al.
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

SHTOJCA NR. 1

NJOFTIM

PËR PËRZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT, PËRFAQËSUES TË MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR ARSIMIN, NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS

Në zbatim të vendimit nr. 782, datë 26.12.2018 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë” dhe urdhrin nr. __, datë __.__.2022, të MAS “Për njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit në Universitetin e Sporteve të Tiranës, mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit”, Ministria e Arsimit dhe Sportit shpall njoftimin për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit në Universitetin e Sporteve të Tiranës, si më poshtë:

Nr.	Institucioni publik i arsimit të lartë	Numri i anëtarëve për Bord Administrimi
1.	Universiteti i Sporteve të Tiranës	<ul style="list-style-type: none"> • 3 anëtarë përfaqësues të MAS • 1 anëtar i përkohshëm, deri në përzgjedhjen e përfaqësuesit të studentëve

1. Përshkrim i përgjithshëm

Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij.

Bordi i Administrimit në institucionet publike të arsimit të lartë përbëhet nga shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të pjesshme. Anëtarët, përfaqësues të IAL-së, përzgjidhen nga Senati Akademik i IAL-së për një mandat pesëvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, prej listave të propozuara nga institucioni i arsimit të lartë. Në listën e kandidatëve jepen të dhënat e individëve që vetëkandidojnë apo propozohen nga njësitë bazë të institucionit të arsimit të lartë apo institucioneve përkatëse. Anëtarët përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe njësisë së qeverisjes vendore janë ekspertë të njohur nga fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike dhe emërohen përkatësisht nga ministri përgjegjës për arsimin dhe kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të ligjit për arsimin e lartë.

2. Kompetencat dhe funksionet e Bordit të Administrimit

Bordi i Administrimit ka këto funksione kryesore:

- garanton qëndrueshmërinë financiare të institucionit të arsimit të lartë dhe përmbushjen e misionit të tij;
- me propozim të Senatit Akademik, miraton planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tij;
- me propozim të Senatit Akademik, miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;
- me propozim të Senatit Akademik, miraton numrin e personelit në të gjitha nivelet;
- vlerëson paraprakisht mbylljen dhe riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë me një institucion tjetër të arsimit të lartë;

- miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive përbërëse të institucionit të arsimit të lartë;
- jep mendim për projektregulloren e institucionit dhe miraton rregulloren financiare të tij;
- përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit;
- është përgjegjës për caktimin e kriterëve e të procedurave për punësimin e administratorëve dhe personelit administrativ, mbështetur në aktet e institucionit të arsimit të lartë;
- emëron dhe shkarkon administratorin e institucionit;
- miraton paraprakisht statutin e institucionit të arsimit të lartë, para se t'i përcillet Senatit Akademik;
- miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga rektorati.

3. Kërkesat e pranimit

a) Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- Të mos ketë ndaj tij masë disiplinore në fuqi e largimit nga detyra.
- Të mos jetë i dënuar penalisht, me vendim gjyqësor të formës së prerë.

b) Kërkesat e veçanta që duhet të plotësojë kandidati

- Të jetë person me profil publik dhe arritje të shquara brenda apo jashtë vendit në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike.
- Të ketë të paktën 10 vjet përvojë pune në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike e juridike. Përparësi do të kenë kandidatët me përvojë praktike në sistemin e arsimit të lartë
- Të ketë integritet etik dhe profesional.
- Të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake.
- Të jetë i padënuar ose ndaj tij të mos jenë dhënë masa sigurie apo dënime me vendim jo përfundimtar për kryerjen e krimeve, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", të ndryshuar.
- Të mos ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".
- Të njohë të paktën një gjuhë të huaj.
- Të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore.

4. Lista e dokumentacionit, vendi dhe afati i dorëzimit

- Kërkesë për aplikim ku të jetë specifikuar IAL ku kandidon;
- Jetëshkrim i plotësuar në gjuhën shqipe (CV-Curriculum Vitae);

- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën “Bachelor”). Për diplomat dhe certifikatat e lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar, jashtë Republikës së Shqipërisë, të përcillet Vërtetimi i Njohjes dhe Njehsimit të Diplomës/Certifikatës, të lëshuara nga strukturat përgjegjëse përkatëse;
 - Fotokopje të librezës së punës;
 - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
 - Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj;
 - Vërtetim që nuk ka masë disiplinore në fuqi për largim nga detyra;
 - Formular i vetëdeklarimit i gjendjes gjyqësore;
 - Vetëdeklarim mbi mosangazhimin në funksione drejtuese partiake, sipas formatit të shtojcës nr. 1/1;
 - Vetëdeklarim mbi konfliktin e interesit, sipas formatit të shtojcës nr. 1/2;
 - Vetëdeklarim për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga kandidati, sipas shtojcës nr. 1/3;
 - Vetëdeklarim se nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".
5. *Paraqitja e dokumenteve të cituara më sipër, do të jetë deri në datën _11.03.2022 në një nga këto mënyra:*
- a) Me postë zyrtare në adresë të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
 - b) Dorëzimi dorazi në ambientet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Dokumentacioni administrohet nga Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, e cila vë në dispozicion të Komisionit “Ad hoc” të ngritur me urdhër Ministri, dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët.

6. *Mënyra dhe koha kur do të shpallet lista e kandidatëve të përzgjedhur*

- Përzgjedhja e kandidatëve për anëtarë të bordit të administrimit kryhet nga një komision “Ad-hoc” i ngritur me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, i cili shqyrton dokumentacionin e paraqitur brenda 10 ditëve pune, nga data e përfundimit të afatit të aplikimit dhe harton listën e kandidatëve të kualifikuar, që plotësojnë kriteret ligjore.
- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Ministria e Arsimit dhe Sportit do të shpallë kandidatët e përzgjedhur në faqen e saj zyrtare, www.arsimi.gov.al.

7. *Masa e shpërblimit*

Bazuar në VKM nr. 656, datë 31.10.2018 “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësisive të qeverisjes qendrore”, i ndryshuar, kufiri maksimal i shpërblimit të anëtarëve në bordin e administrimit në institucionet e arsimit të lartë publik është 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në muaj.

SHTOJCA NR. 1/1

Vetëdeklarim mbi mosangazhimin në funksione drejtuese partiake

Deklaruesi: _____

Unë, i nënshkruari _____, që po paraqes aplikimin tim për anëtar Bordi Administrimi në institucionet publike të arsimit të lartë, deklaroj se _____ i angazhuar në funksione drejtuese partiake.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramit.

Datë _____

Nënshkrimi _____

SHTOJCA NR. 1/2

Vetëdeklarim mbi konfliktin e interesit

Deklaruesi: _____

Unë, i nënshkruari _____, që po paraqes aplikimin tim për anëtar Bordi Administrimi në institucionet publike të arsimit të lartë, deklaroj se _____ në kushtet e konfliktit të interesit që parashikon ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe legjislacioni në fuqi, për të ushtruar këtë detyrë.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramit.

Datë _____

Nënshkrimi _____

SHTOJCA NR. 1/3

Vetëdeklarim për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga kandidati

Unë, i nënshkruari _____, kandidat në procesin e konkurrimit për anëtar bordi në institucionet publike të arsimit të lartë, autorizoj Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, të verifikojë në çdo kohë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga ana ime.

Datë _____

Nënshkrimi _____

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

U R D H Ë R

NR._94, DATË__25.02.2022

PËR

NJOFTIMIN E FILLIMIT TË PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT NË UNIVERSITETIN BUJQËSOR TË TIRANËS, MËNYRËN E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE DHE AFATIN E DORËZIMIT TË DOKUMENTACIONIT

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 48 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën Shqipërisë” dhe të pikës 7, të vendimit nr. 782, datë 26.12.2018 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve

dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë”,

U R D H Ë R O J:

7. Njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, si përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në Universitetin Bujqësor të Tiranës, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri.
8. Përzgjedhja e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Administrimit të kryhet në përputhje me kriteret, procedurën dhe dokumentacionin që duhet dorëzuar, sipas përcaktimeve të vendimit nr.782, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave dhe shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri.
9. Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët për anëtarë të Bordit të Administrimit, do të jetë deri në datë _11.03.2022.
10. Publikimi i kriterëve dhe procedurat që do të ndiqen për konkurrimin, për pozicionin anëtar të Bordit të Administrimit si përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në Universitetin Bujqësor të Tiranës, të bëhet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsimin, Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Qendrës së Botimeve Zyrtare dhe në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik.
11. Lista e kandidatëve të përzgjedhur publikohet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsimin, www.arsimi.gov.al.
12. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

NJOFTIM

PËR PËRZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT, PËRFAQËSUES TË MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR ARSIMIN, NË UNIVERSITETIN BUJQËSOR TË TIRANËS

Në zbatim të vendimit nr. 782, datë 26.12.2018 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë” dhe urdhrin nr. __, datë __. __.2022, të MAS “Për njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit në Universitetin Bujqësor të Tiranës, mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit”, Ministria e Arsimit dhe Sportit shpall njoftimin për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit në Universitetin e Bujqësor të Tiranës, si më poshtë:

Nr.	Institucioni publik i arsimit të lartë	Numri i anëtarëve për Bord Administrimi
1.	Universiteti Bujqësor i Tiranës	<ul style="list-style-type: none"> • 3 anëtarë përfaqësues të MAS • 1 anëtar i përkohshëm,

		deri në përzgjedhjen e përfaqësuesit të studentëve
--	--	--

1. Përshkrim i përgjithshëm

Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij.

Bordi i Administrimit në institucionet publike të arsimit të lartë përbëhet nga shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të pjesshme. Anëtarët, përfaqësues të IAL-së, përzgjidhen nga Senati Akademik i IAL-së për një mandat pesëvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, prej listave të propozuara nga institucioni i arsimit të lartë. Në listën e kandidatëve jepen të dhënat e individëve që vetëkandidojnë apo propozohen nga njësitë bazë të institucionit të arsimit të lartë apo institucioneve përkatëse. Anëtarët përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe njësisë së qeverisjes vendore janë ekspertë të njohur nga fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike dhe emërohen përkatësisht nga ministri përgjegjës për arsimin dhe kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të ligjit për arsimin e lartë.

2. Kompetencat dhe funksionet e Bordit të Administrimit

Bordi i Administrimit ka këto funksione kryesore:

- garanton qëndrueshmërinë financiare të institucionit të arsimit të lartë dhe përmbushjen e misionit të tij;
- me propozim të Senatit Akademik, miraton planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tij;
- me propozim të Senatit Akademik, miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;
- me propozim të Senatit Akademik, miraton numrin e personelit në të gjitha nivelet;
- vlerëson paraprakisht mbylljen dhe riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë me një institucion tjetër të arsimit të lartë;
- miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive përbërëse të institucionit të arsimit të lartë;
- jep mendim për projektregulloren e institucionit dhe miraton rregulloren financiare të tij;
- përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit;
- është përgjegjës për caktimin e kriterëve e të procedurave për punësimin e administratorëve dhe personelit administrativ, mbështetur në aktet e institucionit të arsimit të lartë;
- emëron dhe shkarkon administratorin e institucionit;
- miraton paraprakisht statutin e institucionit të arsimit të lartë, para se t'i përcillet Senatit Akademik;
- miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga rektorati.

3. Kërkesat e pranimit

a) Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- Të mos ketë ndaj tij masë disiplinore në fuqi e largimit nga detyra.
- Të mos jetë i dënuar penalisht, me vendim gjyqësor të formës së prerë.

b) Kërkesat e veçanta që duhet të plotësojë kandidati

- Të jetë person me profil publik dhe arritje të shquara brenda apo jashtë vendit në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike.
- Të ketë të paktën 10 vjet përvojë pune në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike e juridike. Përparësi do të kenë kandidatët me përvojë praktike në sistemin e arsimit të lartë
- Të ketë integritet etik dhe profesional.
- Të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake.
- Të jetë i padënuar ose ndaj tij të mos jenë dhënë masa sigurie apo dënim me vendim jo përfundimtar për kryerjen e krimeve, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", të ndryshuar.
- Të mos ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".
- Të njohë të paktën një gjuhë të huaj.
- Të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore.

8. Lista e dokumentacionit, vendi dhe afati i dorëzimit

- Kërkesë për aplikim ku të jetë specifikuar IAL ku kandidon;
- Jetëshkrim i plotësuar në gjuhën shqipe (CV-Curriculum Vitae);
- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën "Bachelor"). Për diplomat dhe certifikatat e lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara, jashtë Republikës së Shqipërisë, të përcillet Vërtetimi i Njohjes dhe Njehsimit të Diplomës/Certifikatës, të lëshuara nga strukturat përgjegjëse përkatëse;
- Fotokopje të librezës së punës;
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj;
- Vërtetim që nuk ka masë disiplinore në fuqi për largim nga detyra;
- Formular i vetëdeklarimit i gjendjes gjyqësore;
- Vetëdeklarim mbi mosangazhimin në funksione drejtuese partiake, sipas formatit të shtojcës nr. 1/1;
- Vetëdeklarim mbi konfliktin e interesit, sipas formatit të shtojcës nr. 1/2;
- Vetëdeklarim për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga kandidati, sipas shtojcës nr. 1/3;
- Vetëdeklarim se nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".

9. Paraqitja e dokumenteve të cituara më sipër, do të jetë deri në datën 11.03.2022 në një nga këto mënyra:

- c) Me postë zyrtare në adresë të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

d) Dorëzimi dorazi në ambientet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Dokumentacioni administrohet nga Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, e cila vë në dispozicion të Komisionit “Ad hoc” të ngritur me urdhër Ministri, dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët.

10. Mënyra dhe koha kur do të shpallet lista e kandidatëve të përzgjedhur

- Përzgjedhja e kandidatëve për anëtarë të bordit të administrimit kryhet nga një komision “Ad hoc” i ngritur me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, i cili shqyrton dokumentacionin e paraqitur brenda 10 ditëve pune, nga data e përfundimit të afatit të aplikimit dhe harton listën e kandidatëve të kualifikuar, që plotësojnë kriteret ligjore.
- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Ministria e Arsimit dhe Sportit do të shpallë kandidatët e përzgjedhur në faqen e saj zyrtare, www.arsimi.gov.al.

11. Masa e shpërblimit

Bazuar në VKM nr. 656, datë 31.10.2018 “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësisve të qeverisjes qendrore”, i ndryshuar, kufiri maksimal i shpërblimit të anëtarëve në bordin e administrimit në institucionet e arsimit të lartë publik është 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në muaj.

SHTOJCA NR. 1/1

Vetëdeklarim mbi mosangazhimin në funksione drejtuese partiake

Deklaruesi: _____

Unë, i nënshkruari _____, që po paraqes aplikimin tim për anëtar Bordi Administrimi në institucionet publike të arsimit të lartë, deklaroj se _____ i angazhuar në funksione drejtuese partiake.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklarimit.

Datë _____

Nënshkrimi _____

SHTOJCA NR. 1/2

Vetëdeklarim mbi konfliktin e interesit

Deklaruesi: _____

Unë, i nënshkruari _____, që po paraqes aplikimin tim për anëtar Bordi Administrimi në institucionet publike të arsimit të lartë, deklaroj se _____ në kushtet e konfliktit të interesit që parashikon ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe legjislacioni në fuqi, për të ushtruar këtë detyrë.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklarimit.

Datë _____

Nënshkrimi _____

SHTOJCA NR. 1/3

Vetëdeklarim për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga kandidati

Unë, i nënshkruari _____, kandidat në procesin e konkurrimit për anëtar bordi në institucionet publike të arsimit të lartë, autorizoj Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, të verifikojë në çdo kohë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga ana ime.

Datë _____

Nënshkrimi _____

BANKA E SHQIPËRISË
TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: “Realizimi i mobilimit të ambienteve të brendshme të një godine të Bankës së Shqipërisë”.

‘Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit “Tender i hapur kombëtar”, për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 75,800,000 Lekë”.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi “Halili”, Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 214), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë

BIC: STANALTR

IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: “Realizimi i mobilimit të ambienteve të brendshme të një godine të Bankës së Shqipërisë”

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 21 Mars 2022, ora 10:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË I UNIVERSITETIT TË
TIRANËS

Njoftim për vend të lire pune

Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë i Universitetit të Tiranës, shpall konkursin për 1 (një) vend pune vakant për personel akademik me kohë të plotë, të kategorisë “Asistent - Lektor”, pranë Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit, në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës.

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët që do të konkurrojnë për këtë vend pune janë si më poshtë:

➤ Kriteret të përgjithshme:

1. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
2. Të kenë përfunduar studimet universitare të nivelit të parë Bachelor dhe të ciklit të dytë Master i Shkencave ose diploma të barasvlershme me to, në degën Gazetari dhe Komunikim;
3. Nota mesatare për studimet universitare të nivelit të parë bachelor duhet të jetë mbi 9.5 (nëntë pikë pesë).
4. Nota mesatare për studimet universitare të nivelit të dytë Master i Shkencave ose ajo e diplomave të barazvlefshme me të, duhet të jetë gjithashtu mbi 9.5 (nëntë pikë pesë);
5. Të zotërojnë me dëshmi një nga pesë gjuhët e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian: angleze, frënge, gjermane, italiane, spanjolle.
6. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të Gjykatës, për kryerjen e një vepre penale me dashje.
7. Të mos jenë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.

➤ Kriteret e veçanta

1. Preferohen të kenë përfunduar studimet në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë, të Universitetit të Tiranës, ose në një universitet homolog jashtë vendit.
2. Preferohen të kenë përvojë pune të dëshmuar në media mbi 3 (tre) vjet;
3. Preferohen të kenë pjesëmarrje në aktivitete shkencore dhe kualifikime në fushën e medias dhe komunikimit brenda dhe jashtë vendit;
4. Preferohen të kenë njohuri në fushën e gazetarisë televizive, multimedias dhe teknologjive të reja të reja të komunikimit dhe mundësisht kontribute gazetareske publikuar në këto drejtime;

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Degës së Burimeve Njerëzore në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës, këto dokumente:

1. Kërkesë me shkrim;
2. Curriculum vitae;
3. Diplomat e studimeve universitare (fotokopje e noterizuar). Për diplomat e marra në universitetet e huaja duhet të dorëzohet fotokopje e noterizuar e certifikatës së njohjes nga organi kompetent;
4. Listë notash të diplomave përkatëse (fotokopje e noterizuar);
5. Dëshmi të kualifikimeve pasuniversitare (fotokopje e noterizuar);
6. Dëshmi (fotokopje të noterizuara) pjesëmarrjeje në konferenca, seminare, workshop-e etj.
7. Të kenë të paktën 2 (dy) referenca nga profesorët e fushave përkatëse;
8. Dëshmi penaliteti;
9. Dëshmi (fotokopje e noterizuar) e zotërimit të gjuhës së huaj;
10. Certifikatë (fotokopje e noterizuar) e aftësive të përdorimit të programeve kompjuterike;
11. Raport mjekësor për aftësi në punë;
12. Kopje të librezës së punës.

Dokumentet pranohen pranë Degës së Burimeve Njerëzore në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të UT-së, nga data 07.03.2022 - 14.03.2022. Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurrimit me dosje dhe me intervistë të drejtpërdrejtë. Mungesa e një prej dokumentacioneve të kërkuara më sipër, sjell s'kualifikim të kandidatit. Dokumentacioni i dorëzuar nuk do të kthehet mbrapsht, pasi bëhet pjesë e Arkivës së Insitucionit. Afati i dorëzimit të dokumentacionit është 10 ditë pune nga data e shpalljes në Buletinin e APP-së.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

UNIVERSITETI I TIRANËS **Njoftim për vend të lire pune**

Universiteti i Tiranës shpall konkursin për 1 (një) vend të lirë pune, për personel akademik me kohë të plotë, me formim juridik në kategorinë “Profesor” për drejtimin “Legjislacioni dhe institucionet e BE-së”, në Departamentin e Legjislacionit dhe të Politikave të BE-së.

Kandidatët konkurentë për vend vakant në kategorinë “Profesor” për drejtimin “Legjislacioni dhe institucionet e BE-së”, në Departamentin e Legjislacionit dhe të Politikave të BE-së, në Institutin e Studimeve Evropiane, në UT, duhet të plotësojnë kriteret si më poshtë:

- Kriteret të përgjithshme:

1. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
2. T'i përkasin kategorisë “Profesor”;
3. Të kenë fituar gradën shkencore “Doktor” dhe titujt akademikë në fushën e drejtësisë;
4. Të ketë experiencë në mësimdhënie dhe në kërkim shkencor në fushën juridike, të paktën prej 15 vjet;
5. Të zotërojnë një nga 5 gjuhët e Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht);
6. Të mos ketë qenë i/e dënuar me vendim penal të formës së prerë nga gjykata për kryerjen e një veprë penale me dashje;
7. Të mos jetë marrë ndaj tij/saj masa disiplinore e largimit nga puna.

- Kriteret të veçanta:

1. Preferohet të kenë kryer të gjitha ciklet e studimit në UT, në fushën e drejtësisë;
2. Preferohet të kenë titullin akademik “Profesor”;
3. Të kenë experiencë mësimdhënieje në ISE;
4. Preferohet të kenë experiencë në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe publikime në fushën juridike brenda dhe jashtë vendit.

I. Sistemi i vlerësimit

Kandidatët vlerësohen bazuar në dokumentet e dorëzuara në dosje dhe në intervista me gojë.

II. Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Kërkesë me shkrim për aplikim;
- Jetëshkrimi (CV);
- Fotokopje e noterizuar e dokumentit të identifikimit;

- Fotokopje e noterizuar e të gjitha diplomave apo titujve që zotëron kandidati dhe listës së notave (për diplomat e marrë jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njësimi nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë);
- Fotokopje e librezës së punës (në të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë) e noterizuar;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnime, kualifikime, arsimin shtesë, pjesëmarrje në konferenca, botime shkencore etj;
- Dëshmi e penalitetit ose formular vetëdeklarimi;
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vlerësim pune/ rekomandime nga punëdhënës/ profesorë;
- Dëshmi e gjuhës së huaj.

Dokumentacioni i mësipërm të dorëzohet pranë zyrës së Protokollit të Institutit të Studimeve Evropiane, në një periudhë dyjavore nga publikimi, duke filluar nga data 07.03.2022-18.03.2022.

UNIVERSITETI I TIRANËS

Njoftim për vend të lire pune

Rektorati i Universitetit të Tiranës shpall konkursin për 2(dy) vende të lira pune për personel ndihmësakademik me karakter administrativ, të emërtesës “specialist” në Sektorin e Inovacionit dhe Statistikave, në Drejtorinë e Teknologjisë, Inovacionit dhe Statistikave, si dhe vendin e punës “Specialist” në Sektorin Juridik, në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme.

1. Kandidatët konkurrentë për vendin e punës, “specialist” në Sektorin e Inovacionit dhe Statistikave, duhet të plotësojnë këto kritere:

Kriteret e përgjithshme:

1. Të jenë shtetas shqiptar me zotësi të plotë për të vepruar.
2. Të zotërojnë minimalisht diplomë të nivelit "Master Profesional", preferohet në fushën e Ekonomiksit, Statistikë Informatike, Informatikës ose Matematikës.
3. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje.
4. Të mos jetë marrë ndaj tij masa disiplinore e largimit nga puna.

Kriteret e veçanta:

1. Të ketë eksperiencë pune jo më pak se 1-vit, preferohet ekesperiencë pune në sektorë të ngjashëm.
2. Të ketë aftësi komunikuese dhe të punës në grup.
3. Të ketë aftësi analizuese dhe përgjithësuese.
4. Të ketë njohuri të mira në programet kompjuterike të cilat lidhen me fushën e punës, të provuara me dëshmi.
5. Të njohë me dëshmi gjuhën angleze.

2. Kandidatët konkurrentë për vendin e punës “Specialist” në Sektorin Juridik, duhet të plotësojnë këto kritere:

Kritere të përgjithshme

1. Të jenë shtetas shqiptarë me zotësi të plotë për të vepruar;
2. Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master i Shkencave” ose diplomë ekuivalente me të në Drejtësi. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. Për diplomat e fituara jashtë vendit, të jetë bërë njohja e tyre nga ministria përgjegjëse për arsimin;
3. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje;
4. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.

Kritere të veçanta

1. Preferohet të kenë eksperiencë pune deri në 1 vit;
2. Të njohin shumë mirë legjislacionin në fuqi, preferohet atë në arsimin e lartë;
3. Të kenë njohuri shumë të mira në përdorimin e kompjuterit, të provuara me dëshmi;
4. Të njohin një gjuhë të huaj, preferohet gjuha angleze, e provuar me dëshmi;
5. Të kenë aftësi të mira komunikimi, etikë profesionale dhe të dijë të punojë në grup.

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, këto dokumenta:

1. Kërkesë me shkrim;
2. Curriculum vitae;
3. Diplomë e studimeve universitare dhe lista e notave (fotokopje e noterizuar). Për diplomat e marra në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet fotokopja e noterizuar e certifikatës së njohjes nga institucioni përgjegjës;
4. Të paktën dy referenca nga punëdhënësit e mëparshëm;
5. Dëshmi penaliteti;
6. Dëshmi e zotërimit të gjuhës së huaj (fotokopje e noterizuar);
7. Dëshmi që të vërtetojë njohuritë e përdorimit të kompjuterit (fotokopje e noterizuar);
8. Kopje të librezës së punës (fotokopje e noterizuar);
9. Raport mjekësor për aftësinë në punë.

Dokumentat pranohen në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Sheshi “Nënë Tereza”, Tiranë, nga data 07.03.2022 - 21.03.2022. Përzgjedhja e kandidatëve fitues do të bëhet nëpërmjet konkurimit me dosje dhe me intervista të drejtëpërdrejta.

FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA, UNIVERSITETI I TIRANËS**Njoftim për vend të lirë pune**

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 66, pika 4, si dhe referuar Satutit të UT-së, neni 80, pika 4 të miratuar me Urdhërin Nr. 816, datë

26.12.2018 të MASR, kërkon të punësojë në vendet e lira të punës për personel Ndihmës Akademik me karakter Administrativ me kohë të plotë pranë Njësisë Kryesore si më poshtë:

Kandidatët që konkurojnë për “Psikologë” 1 (një) vend puneduhet të plotësojnë këto kritere të përgjithshme:

1. Të jetë diplomuar në Master i Shkencave, Master Profesional ose DNID në fushën e Psikologjisë
2. Të njohë një prej pesë gjuhëve të huaja të BE-së: anglisht, frëngjishtë, gjermanisht, italisht, spanjisht.
3. Të jetë shtetas shqiptar me zotësi të plotë për të vepruar.
4. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata për kryerjen e një vepre penale me dashje.
5. Të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna.

Kritere të veçanta:

1. Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi dhe të dijë të punojë në grup
2. Të njohë me dëshmi programet bazë kompjuterike

Kandidatët që konkurojnë “ Përgjegjës qendre” në degen e Qendrës së Gjuhëve të Huaja duhet të plotësojnë këto kritere të përgjithshme:

1. Të jetë diplomuar në Master i Shkencave, Master Profesional ose DNID në Fushën e Shkencave Shoqerore .
2. Të njohë një prej pesë gjuhëve të huaja të BE-së: anglisht, frëngjishtë, gjermanisht, italisht, spanjisht.
3. Të jetë shtetas shqiptar me zotësi të plotë për të vepruar.
4. Të njohë me dëshmi programet bazë kompjuterike
5. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata për kryerjen e një vepre penale me dashje.
6. Të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna.

Kritere të veçanta:

1. Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi dhe të dijë të punojë në grup
2. Të ketë minimumi 5(pesë) vite eksperiencë pune

Kandidatët që aplikojnë për këto vende pune duhet të dorëzojnë pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës, këto dokumenta:

1. Kërkesë me shkrim për pozicionin e punës që aplikon
2. Jetëshkrim i plotësuar në gjuhën shqipe (CV-Curriculum Vitae)
3. Diplomë dhe listë notash për të gjitha ciklet e studimeve universitare (të notuar). Për diplomat e marra në universitete e huaja, duhet të dorëzohet fotokopje e notuar e certifikatës së njohjes nga strukturat përgjegjëse përkatëse.
4. Dëshmi e zotërimit të gjuhës së huaj (të notuar)
5. Të paktën një referencë nga punëdhënësi i fundit (nese ka)
6. Kopje e librezës së punës dhe të kontributeve të sigurimeve shoqërore.
7. Raport mjeko-ligjor për aftësinë në punë

8. Dokument identifikimi
9. Dëshmi penaliteti ose formular vetedeklarim

Përzgjedhja e kandidatëve fitues do të bëhet nëpërmjet konkurimit me dosje dhe me intervista të drejtpërdrejta.

Afati i dorëzimit të dokumentave është nga data 07/03/2022 – 21/03/2022

UNIVERSITETI “ALEKSANDER XHUVANI” Elbasan

Njoftim për vend të lire pune

Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Rektoratin e Universitetit “Aleksander Xhuvani” shpall konkurs për pozicionin e punës 1 (një) personel ndihmësakademik me karakter administrativ, me kohë të plotë, specialist IT në Sektorin e IT-së, Specialisti i Sektorit të IT-së përgjigjet për:

- Është nënpunës i nivelit ekzekutiv; mban përgjegjësi për mbarëvajtjen e burimeve informatike dhe infrastrukturës, duke përfshirë sistemet e shkëmbimit të informacionit, rrjetin kompjuterik hardware (pajisjet kompjuterike) dhe software (programet) si dhe mjetet e tjera të komunikimit në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- përgjigjet për zgjidhjen ligjore dhe teknike të problemeve të sektorit të IT në përputhje me përshkrimin e punës. Bashkëpunon me specialistët e sektorit si dhe strukturat brenda dhe jashtë drejtorisë për zgjidhjen e problemve të ndryshme. Në rast mosmarrëveshesh me struktura të tjera UE-së, njofton përgjegjësin e sektorit ose drejtorin i cili ndjek zgjidhjen e konfliktit. Punon për realizimin e detyrave të ngarkuara nga aktet nën ligjore ose nga eprorët brenda afatit dhe raportimin e tyre. Kryen me përpikmëri në nivel profesional të gjitha detyrat e ngarkuara.

Kriteret e përgjithshme:

- të zotërojë diplomë të ciklit (nivelit) të dytë të studimeve Master, në fushën e teknologjisë së informacionit.
- të ketë përvojë pune.
- të ketë njohuri të paktën e një gjuhe të huaj të vertëtuuar me dokumentacion.
- të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.
- ndaj tij të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
- të jetë i aftë për punë.

Kriteret e veçanta:

- Të ketë kryer trajnime apo kualifikime në fushën përkatëse
- Referenca pune nga punëdhënësit;
- Të kenë aftësi të mira komunikuese e të punës në grup.

Kandidatët duhet të dorëzojnë në rrugë postare në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore Protokoll Arkiv të Rektoratit të Universitetit të Elbasanit “Aleksander Xhuvani” brenda 10 (dhjetë) ditëve

(07.03.2022 - 16.03.2022) nga data e shpalljes në www.app.gov.al dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:

- Letër motivimi për pozicionin e punës specialist i Sektorit të IT-së në Drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
- Jetëshkrimin e tij/saj;
- Fotokopje e diplomës e njehsuar me origjinalin. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë të njehsuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
- Fotokopje e listës së notave e njehsuar me origjinalin. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar;
- Fotokopje e njehsuar e librezës së punës;
- Çertifikata, kualifikime, dëshmi, për aftësi të ndryshme, të njehsuara me origjinalin;
- Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj e njehsuar me origjinalin;
- Raport i gjendjes shëndetsore, që vërteton aftësinë për punë;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Fotokopje e letërnjoftimit.

Dokumentacioni i kërkuar të dorëzohet në rrugë postare brenda 10 (dhjetë) ditëve (07.03.2022 - 16.03.2022) nga data e shpalljes në www.app.gov.al në adresën:

Konkursi do të zhvillohet në ambientet e Rektoratit. Komisioni ad-hoc do të vlerësojë paraprakisht dosjet e kandidatëve dhe më pas kandidatët do ti nënshtohen intervistës me gojë (18.03.2022 – 31.03.2022). Kandidatët konkurues do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurrimit, orën dhe datën e intervistës dhe për shpalljen /njoftimi i fituesit.

SPITALI RAJONAL “MEMORIAL” FIER

Njoftim për vend të lire pune

Në zbatim të Ligjit Nr. 23/2021 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, mbi dhurimin në fushën e shëndetësisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 175, datë 17.03.2021 “Për ngritjen, organizimin dhe funksionimin e Spitalit Rajonal “Memorial” në Fier, si projekt pilot”, në Urdhrin e MSSH nr. 182/1 prot. datë 25.03.2021 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Spitalit Rajonal “Memorial” Fier , në Urdhërin e MSSH nr.503, datë 22.11.2021 ‘Për ndryshim strukture’ në Urdhërin Nr. 511 datë 13.12.2011 të Ministrit të Shëndetësisë “Për kriteret e Punësimit në Shërbimin Shëndetësor Publik”, si dhe në kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm të Spitalit Rajonal “Memorial” Fier, shpall konkursin për 1 (një) vend të lirë pune, në pozicionin:

‘SPECIALIST STATISTIKE’ në Sektorin e Financës dhe Statistikës / Drejtorin e Financës dhe Shërbimeve të Përgjithshme pranë Spitalit Rajonal “Memorial” Fier.

Kandidatët që konkurojnë për vendin e lirë të punës duhet të plotësojnë këto kriteret:

- Të jenë shtetas shqiptarë;

- Të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të kenë diploma universitare të nivelit të dytë në shkencat ekonomike;
- Të jenë të aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos kenë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik;
- Të njofi programet e kompjuterit MSO, etj.
- Trajnimet, kualifikimet apo dëshmi në fushën e Financës përbëjnë avantazh.
- Të kenë aftësi të mira të punës në grup dhe menaxheriale;

Dokumentacioni që duhet të paraqesin konkurrentët : Kandidati/ja duhet të paraqesë në sekretarinë e Drejtorisë së Spitalit Rajonal ‘Memorial’ Fier brenda shtatë (7) ditëve nga data e botimit të këtij njoftimi në Buletinin e APP këto dokumenta:

- Letër motivimi
- Jetëshkrimi (CV)
- Fotokopje të noterizuar e diplomës të shkollës së lartë.(Për kandidatët që kanë studiuar jashtë vendit diploma e tyre duhet të jetë e njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit);
- Fotokopje e noterizuar e librezës së punës;
- Dëshmi të aftësisë shëndetësore për punë e 3 (tre) muajve të fundit;
- Fotokopje e letërnjoftimit (ID);
- Referencë pune (n.q.s ka qënë i/e punësuar), për të vërtetuar përvojën e auditimit e brendshëm;
- Vërtetim banimi;
- Vërtetim nga gjykata,dhe prokuroria që nuk është në ndjekje penale dhe gjykimi;
- Vërtetimi i gjendjes gjyqësore lëshuar nga Ministria e Drejtësisë (Dëshmi penaliteti e tre muajve të fundit);
- Çertifikatë familjare/personale
- Çertifikata ose rekomandime që vërtetojnë eksperiencën profesionale si dhe integritet moral dhe reputacion të mire;

Kandidatët që janë nëpunës brenda Spitalit Rajonal “Memorial” Fier duhet të plotësojnë këto kushte minimale :

- Të jenë punonjës të konfirmuar të Spitalit Rajonal “Memorial” Fier,
- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi,
- Të kenë të paktën një vlerësim pozitiv.

Mosparaqitja e dokumentave ose mosparaqitja e plotë e tyre, sjell s’kualifikim të kandidatit;

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin dokumentat brenda shtatë (7) ditëve nga shpallja e këtij njoftimi, pranë sekretarisë së Drejtorisë së Spitalit Rajonal “Memorial” Fier.

Për datën dhe orën e zhvillimit të konkursit/intervistës kandidatët e interesuar do të njoftohen nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

BANKA E SHQIPËRISË
TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: “Realizimi i lidhjes online ndërmjet godinave të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë tre vjeçare”.

‘Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit “Tender i hapur kombëtar”, për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 12,000,000 Lekë”.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi “Halili”, Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 214), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë

BIC: STANALTR

IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: “Realizimi i lidhjes online ndërmjet godinave të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë tre vjeçare”

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 24 Mars 2022, ora 10:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
Njoftim për vend të lirë pune

Agjencia e Sigurimit të Depozitave për nevoja të plotësimit të vendeve të punës, shpall për konkurim 1 vend të lirë pune, në pozicionin si vijon:

- “Kryespecialist për çështjet e administratës”, pranë Sektorit të Administratës dhe Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave;

Kandidatët që kërkojnë të aplikojnë për konkurim duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

Kritere të përgjithshme:

- Të kenë si rregull shtetësinë shqiptare;
- Të gëzojnë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të përmbushin kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojnë aftësitë profesionale të domosdoshme për vendin përkatës të punës sipas kriterëve të miratuara;
- Të jenë të aftë për punë;
- Të mos jenë të dënuar me një vendim gjykatë të formës së prerë për kryerjen e një krimi;

- Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore;
- Të angazhohen të respektojnë zbatimin e ligjit “Për Sigurimin e Depozitave”, të ndryshuar, si dhe dispozitat e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Kritere specifike për pozicionin e punës “Kryespecialist për çështjet e administratës”, pranë Sektorit të Administratës dhe Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave:

- Preferohet të jetë diplomuar në Fakultetin Ekonomik/ Inxhinjerisë/Juridik/Shkenca filologjike;
- Të ketë jo më pak se 3 vjet eksperiencë pune në nivel administrimi;
- Aftësi për të kuptuar propozimet dhe vendimet e cdo niveli dhe për ti zbatuar ato;
- Të ketë aftësi për të kryer me përgjegjësi detyrën në përputhje me aktet ligjore në fuqi;
- Aftësi komunikuese me shkrim (në hartimin e shkresave zyrtare) e me gojë;
- Njohuri në përdorimin e programe Word, Excel, Power Point;
- Njohuri të mira të gjuhës angleze; njohja e një gjuhe të dytë ndërkombëtare përbën avantazh;
- Nota mesatare preferohet mbi 8 (tetë);
- Të ketë aftësi shumë të mira të komunikimit, organizimit dhe punës në grup;
- Të ketë aftësi për të zhvilluar njohuritë akademike dhe profesionale, të ndjekë ndryshimet dhe përmirësimet e legjislacionit shqiptar që lidhen me fushën e sigurimit të depozitave.
- Të ketë angazhimin për të përballuar mbingarkesë dhe punë me orar të zgjatur.
- Të jetë i aftë të kryejë detyra të tjera të caktuara nga eprorët përkatës.

Fushat e njohurive, dhe literatura mbi të cilat do të zhvillohet testimi dhe intervista për pozicionin e punës “Kryespecialist për çështjet e administratës”, pranë Sektorit të Administratës dhe Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave.

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë;
- Ligji Për Sigurimin e Depozitave;
- Statuti i Agjencisë;
- Ligji Për prokurimin publik;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar;
- “Kodi i Etikës i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”;
- Rregullore Për punën me dokumentat administrative dhe korrespondencën elektronike në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave;
- Rregullore Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave;
- Rregullore Mbi procedurat dhe kriteret e zhvillimit të burimeve njerëzore;
- Rregullore Mbi kryerjen e praktikës mësimore të studentëve me arsim të lartë pranë Agjencisë së Sigurimit të Depozitave;
- Rregullore “Mbi marrëdhëniet e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave me bashkëpunëtorët e jashtëm”;
- Udhëzimi “Për strukturën dhe nivelin e pagave bazuar në klasifikimin e vendeve përkatëse të punës në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”;
- Udhëzimi “Për kuotat dhe procedurat e kryerjes së shpenzimeve të nevojshme lidhur me aktivitetet zyrtare të ASD -së”;

- Udhëzimi “Për shpenzimet e daljes brenda dhe jashtë shtetit për shërbim, kualifikim, specializim, etj të personelit të ASD –së”;
- Udhëzimi “Për shpenzimet për pritjen, përcjelljen dhe trajtimin që u bëhet personaliteteve të shtetit shqiptar dhe delegacioneve të huaja, që vijnë në ASD”;
- Akteve të tjera nënligjore të Agjencisë të miratuara nga Këshilli Drejtues.

Kandidatët që do të aplikojnë për konkurim duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- Curriculum Vitae;
- Diplomë të shkollës së lartë (sipas kërkesës së vendit përkatës së punës);
- Listë notash;
- Dokumenti i Laurimit në gradë shkencore, në qoftë se ka;
- Dëshmi të ndryshme kualifikimi dhe specializimi;
- Dëshmi të gjuhëve të huaja;
- Vërtetim shëndetësor nga Komisioni Mjeko-Ligjor;
- Vërtetim nga prokuroria, gjykata dhe dëshmi penaliteti, ku të vërtetohet që nuk jeni i dënuar ose në ndjekje penale;
- Çertifikatë e gjendjes familjare;
- Të mos jetë i larguar nga puna për masa disiplinore në bazë të ligjit për nëpunësin e shërbimit civil në Republikën e Shqipërisë dhe/ ose Kodit të Punës;
- Fotografi 2 copë;
- Fotokopje e ID-së.

Si dhe të paraqiten pranë Agjencisë së Sigurimit të Depozitave (Rruga Elbasanit, Pall Edil Al It, Nr. 317, Tiranë) për të tërhequr formën e aplikimit, çdo ditë pranë Sektorit të Administratës dhe Burimeve Njerëzore ose mund ta gjejnë atë në link-un e mëposhtëm në faqen tonë zyrtare në internet:

www.asd.gov.al

Konkurimi në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave bëhet në bazë të procedurave të miratuara nga Këshilli Drejtues i Agjencisë me dy faza:

1. Në fazën e parë, bëhet përzgjedhja e kandidatëve që do t'i nënshtrohen testimit të mëtejshëm, e cila konsiston në verifikimin nëse dokumentacioni i paraqitur nga çdo kandidat vërteton plotësimin e kërkesave të përgjithshme dhe të kërkesave specifike, të përcaktuara në shpalljen për konkurim. Vetëm kandidatët që plotësojnë këto kërkesa, i nënshtrohen fazave të mëtejshme të konkurimit.
2. Në fazën e dytë, zhvillohet testimi i kandidatëve në dy etapa:
 - i. për zotërimin e gjuhës angleze;
 - ii. për nivelin e njohurive profesionale.

Në qoftë se rezultati i testimit për zotërimin e gjuhës së huaj është nën nivelin minimal të përcaktuar, kandidati nuk kualifikohet për fazat e mëtejshme të konkurimit.

Dokumentacioni të paraqitet në formë shkresore dhe elektronike me email brenda datës 15.03.2022. Pas kësaj date nuk pranohet asnjë dokument. Data e zhvillimit të fazës së dytë të konkurimit do të caktohet në një njoftim të dytë.

- Kandidati, i cili dëshiron të konkurrojë, mund të paraqitet çdo ditë pranë Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, për tu njohur me kriteret e vendeve të punës të shpallura për konkurim dhe për të plotësuar kërkesën përkatëse sipas formatit të miratuar nga Agjencia;
- Dokumentacioni i kërkuar të dorëzohet në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave, i mbyllur në zarf me adresën përkatëse dhe të jetë i plotësuar sipas kërkesave të mësipërme, si dhe në formë elektronike në adresën lhado@asd.gov.al

(Dokumentacioni duhet të jetë origjinal ose fotokopje e noterizuar, mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit).

UNIVERSITETI I SHKODRËS “LUIGJ GURAKUQI”

njoftim për vend të lire pune

Njoftohen të gjithë të interesuarit se në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, shpallet konkursi për 1 vend të lirë pune në Fakultetin e Drejtësisë, në pozicionin Asistent/Lektor/e në Departamentin e së Drejtës Ndërkombëtare Europiane.

Kandidati/ja duhet të plotësojë këto kriteret specifike:

1. Të ketë kryer studimet universitare dhe pasuniversitare me kohë të plotë në Drejtësi.
2. Të ketë kryer ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave në Drejtësi me notë mesatare jo më pak se 9.5.
3. Për kandidatët që kanë kryer studimet në sistemin 4 vjeçar mesatarja e tyre të jetë jo më 9.5
4. Për të diplomuarit jashtë vendit kërkohet çertifikata e njohjes nga MAS.
5. Të kenë të mbrojtur një gjuhë të huaj perendimore (preferohet anglisht) me notë mesatare jo më të ulët se 9.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kriteret të përgjithshme :

1. Të kenë aftësi të punës në grup dhe aftësi komunikimi profesional.
2. Mos të jenë të dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.
3. Të mos jetë marrë ndaj tyre masë disiplinore sipas parashikimit në kodin e punës.
4. Të mos jetë larguar nga USH pa miratimin e këtij të fundit.
5. Të mos ketë lidhje familjare (bashkëshort/bashkëjetues, bir/bijë dhe fëmijët e tyre), gjinie(prindër, motër e vëlla dhe fëmijët e tyre emtë a ungj) apo krushqie(prind, fëmijë, vëlla/motër i/e bashkëshortit/es si dhe bashkëshort/bashkëjetues i fëmijëve) me punonjës ekzistues brënda njësisë bazë të Fakultetit të Drejtësisë.
6. Të mos kenë prishur në mënyrë publike imazhin e USH-së.

Preferohen që kandidatët të kenë :

1. Eksperiencë mësimdhënieje në universitetet publike brënda ose jashtë vendit.

Kandidatët do të nënshtrohen konkurimit me dosje, testimi me shkrim, intervistës dhe leksionit të hapur.

Kandidatët duhet të paraqesin këto dokumenta:

1. Kërkesë me shkrim për aplikim.
2. Curriculum Vitae me foto personale.
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit.

4. Diplomë të Shkollës së Lartë ose fotokopje dhe lista e notave (të noterizuara).
5. Dy rekomandime nga mësimdhënës me grada/tituj shkencorë.
6. Fotokopje të artikujve të botuar, teksteve universitare apo parauniversitare, projekte shkencore, punime të tjera.
7. Dëshmi të njohjes së gjuhës së huaj të njohur zyrtarisht nga Ministria e Arsimit
8. Dëshmi për kualifikime të ndryshme, pjesmarrje në konferenca, seminare, trajnime, workshope etj.
9. Vërtetim nga prokuroria, gjykata si dhe dëshmi penaliteti.
10. Vërtetim i gjendjes shëndetësore (raport mjekësor për aftësinë në punë).
11. Vërtetim nga qendra e punës në të cilën ka punuar ose punon ose vërtetim papunësie nga zyra e punës.
12. Deklaratë që provon kushtet e pikës 3/c, të nenit 8 të Rregullores së posaçme të Universitetit për zënien dhe ruajtjen e vendit të punës(për moslidhje farefisnore).
13. Dokument identifikimi vetjak(fotokopje pasaporte, letërnjoftimi ID).
14. Listë përmbledhëse e dokumenteve të dorëzuara nga konkurenti.
15. Çdo dokument tjetër që vërteton kërkesat e mësipërme.

Të gjithë dokumentet e mësipërme duhet të jenë origjanel ose të fotokopjuara dhe të noterizuara sipas legjislacionit në fuqi.

Shënim :

- Kontrata e punës do të jetë me afat 1 vjeçar (vit akademik) me të drejtë rinovimi.
- Kandidatët duhet të dorëzojnë postë pranë zyrës së protokollit në Rektoratin e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, me shënimin mbi zarf “Aplikim për pedagog në FD”.
- Konkursi do të zhvillohet me dosje, intervistë dhe leksion të hapur brënda 3 javëve nga publikimi i njoftimit sipas orarit që do të përcaktojë Departamenti.
- Për hollësi të mëtejshme, si programi, mënyra e zhvillimit të konkursit , t’i drejtoheni Departamentit përkatës.